



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

OPINION LIGJOR

PËR RAPORTIN VJETOR TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) është institucion i pavarur i krijuar me ligjin Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. KMD në kuadër të misionit të tij e shtrin veprimtarinë e tij në tre sfera kryesore: 1) Shqyrton ankimet e viktimave të diskriminimit, ku pas kryerjes së hetimit administrativ, mbi rastin, merr masa deri në vendosjen e sanksioneve administrative; 2) Monitoron cilësinë e zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi 3) Ushtron funksionin e tij në drejtim të ndërgjegjësimit mbi diskriminimin.

Pas njohjes me raportin vjetor të KMD-së për vitin 2021, KShH parashtron qendrimin e saj si vijon:

1. Zyra e KMD, ka 34 punonjës në strukturën e saj. Është pozitiv fakti se me strukturën e re, tre zyrat rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në qytetet Korçë, Fier, Shkodër, shndërrohen në zyra të përhershme. Mgjth, KShH vlerëson se është e nevojshme të analizohej mjaftueshmëria e stafit që vepron pranë zyrës së KMD-së, në raport me fluksin e ankesave që trajtojnë, por edhe cilësinë e përmbushjes së detyrave të tjera funksionale.

2. Në periudhën nga 1 Janar 2021 deri në 31 Dhjetor 2021, KMD ka trajtuar gjithsej 324 çështje, (302 ankesa dhe 22 çështje ex-officio). Nga këto, 257 çështje (242 ankesa dhe 15 çështje ex officio) janë të regjistruara në vitin 2021 dhe 67 çështje (60 ankesa dhe 7 çështje ex-officio) janë të mbartura nga viti 2020. Gjatë vitit 2021 rezulton një rritje me 43% e numrit të çështjeve të trajtuara nga KMD në raport me vitin 2020, gjatë të cilit janë trajtuar gjithsej 226 çështje. Në mënyrë progresive sikurse numri total i çështjeve të trajtuara gjatë këtij viti rezulton edhe numri i çështjeve të reja të regjistruara në 2021, 257 të tilla, në raport me 174 çështje të reja që janë regjistruar gjatë 2020. Konstatohet një rritje me rreth 47% e çështjeve të reja për 2021 në raport me vitin 2020.¹

Vlerësojmë se do të ishte shumë e rëndësishme të analizohej në raport, cilat janë shkaqet e rritjes me 43% e numrit të çështjeve të trajtuara nga KMD dhe rritjen me rreth 47% e numrit të çështjeve të reja për 2021 në raport me vitin 2020. E themi këtë pasi është me interes të kuptohet nëse kjo rritje vjen si rezultat i forcimit të kapaciteteve të zyrës së KMD-së dhe rritjes së ndërgjegjësimit të shtetasve dhe subjekteve që i janë drejtuar zyrës apo për faktin se ka një rritje të formave të diskriminimit gjatë vitit që lamë pas.

¹ FQ 34 dhe 35 e Raportit Vjetor 2021 të KMD



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

3. Nga 257 çështje të reja të regjistruara në 2021, 63 ankesa kanë ardhur nga Zyrat Rajonale, konkretisht: 23 ankesa ardhur nga Zyra Rajonale Shkodër, 19 ankesa ardhur nga Zyra Rajonale Korçë dhe 21 ankesa ardhur nga Zyra Rajonale Fier.²

Nga analiza e numrit të ankesave të regjistruara gjatë vitit 2021 dhe mënyrës së mbërritjes së tyre vërehet se 24.5 % e numrit total të çështjeve të reja të regjistruara gjatë vitit 2021 kanë mbërritur nga 3 zyrat rajonale. Kjo tregon se shtrirja e shërbimeve të Zyrës së KMD-së në territor, kombinuar me rritjen e shkallës së informimit qytetar mbi mbrojtjen që ofron legjislacioni apo mekanizmat anti diskriminim do i shërbejë trajtimit më të mirë të rasteve duke çuar në identifikimin më të lartë të sjelljeve apo shfaqjeve që përbëjnë diskriminim, rrjedhimisht edhe trajtimit dhe sanksionimit të tyre.

4. Nga 324 çështje që janë trajtuar gjatë vitit 2021, për 302 çështje ka filluar shqyrtimi në bazë të ankesës, nga të cilat në 261 raste ankesat janë paraqitur nga individë (214 ankesa të regjistruara gjatë vitit 2021 dhe 47 ankesa të regjistruara në vitin 2020), në 28 raste, ankesat janë paraqitur nga organizata me interesa legjitime (20 ankesa të regjistruara në vitin 2021 dhe 8 ankesa të regjistruara në vitin 2020), në 13 raste ankesat janë paraqitur nga grup personash (8 ankesa të regjistruara gjatë vitit 2021 dhe 5 ankesa të regjistruara në vitin 2020). Nga këto, rezulton se 6 ankues janë asistuar nga OJF të ndryshme për të depozituar ankesë pranë KMD-së, ndërkohë që në vitin 2021, në 19 raste ankuesit janë asistuar nga organizata të shoqërisë civile, për të depozituar ankesë.³

Në analizë të këyre shifrave rezulton se vetëm 10 % e çështjeve që janë trajtuar gjatë vitit 2021 kanë mbërritur nga ankues të mbështetur ose të asistuar nga organizata të shoqërisë civile. Duke mbajtur parasysh se janë të shumta organizatat e shoqërisë civile të cilat në kuadër të misionit të tyre ofrojnë shërbime ligjore falas për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, do të jetë efektive që Zyra e KMD të promovojë një bashkëpunim të shtuar organizatat vendase. Kjo do i shërbejë identifikimit më të lartë të rasteve të diskriminimit, rritjes së besimit të KMD-së tek OSHC-të shqiptare por edhe rritjes së ritmeve dhe cilësisë të shqyrtimit të ankesave. Kjo për shkak të kapaciteteve të organizatave dhe njohjes së tyre me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi, duke mundësuar paraqitjen e ankesave më të strukturuar në formë dhe më të mbështetura në ligj dhe fakte.

5. Gjatë vitit 2021, shpërndarja e çështjeve të trajtuara sipas 3 fushave, punësim, arsim, të mira shërbime, vazhdon të jetë e ngjashme me atë të vitit 2020. Çështjet në fushën e arsimit zënë 4% të totalit të çështjeve të trajtuara duke pësuar me një zbritje të lehtë krahasuar me vitin 2020, ku këto çështje zinin 7% të totalit të çështjeve. Çështjet në fushën e punësimit zënë 52% të totalit të çështjeve të trajtuara gjatë vitit 2021 me një zbritje të vogël (në përqindje) krahasuar me vitin 2020, ku këto çështje zinin 56% të totalit të çështjeve, edhe pse numri i çështjeve në këtë fushë gjatë vitit 2021 ka patur rritje krahasimisht me vitin 2020.

² Fq 36 e Raportit Vjetor 2021 të KMD

³ Fq 37 dhe 38 e Raportit Vjetor 2021 të KMD



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Gjatë vitit 2021, çështjet në fushën e të mirave dhe shërbimeve zënë 44% të totalit të çështjeve të trajtuara krahasuar me 2020, ku këto çështje zinin 37% të totalit të çështjeve të trajtuara. Gjatë vitit 2021, krahasimisht me 2020 vihet re një rritje e konsiderueshme e çështjeve në fushën e të mirave dhe shërbimeve.⁴

Duke mbajtur parasysh se gjatë vitit 2021, shpërndarja e çështjeve të trajtuara në fushat e punësimit, arsimit, të mirave dhe shërbimeve, është e ngjashme me atë të vitit 2020, vlerësojmë se Zyra e KMD në përputhje me kompetencat e saj ligjore, krahas trajtimit të ankesave duhet të mbajë në konsideratë edhe nxitjen e debatit për ndryshime ligjore apo të politikave përkatëse, pranë institucioneve kompetente, me qëllim për ti shërbyer adresimit më të plotë të fenomeneve diskriminuese që shfaqen në këto fusha.

6. Duke mbajtur parasysh se një pjesë e mirë e ankesave drejtohen edhe ndaj institucioneve të administratës qendrore dhe asaj vendore, por edhe punëdhënësve apo ofruesve privatë të shërbimeve, të cilat lidhen me mosfrimin apo garantimin e një sërë shërbimesh, Zyra e KMD-së duhet të vihet në lëvizje dhe të vendosë kontakte, me këto institucione/ ente private, për të parë mënyrën e përmushjes së detyrimeve ligjore prej tyre. Gjithashtu monitorimi i tyre duhet të ndodhe në mënyrë më të shpeshtë dhe të plotë por edhe mbi baza sistematike dhe periodike. Kjo veprimtari do të shërbejë identifikimit të problematikave apo shkaqeve të cilat sjellin diskriminim.

7. Në fushën e të mirave dhe shërbimeve, në fushën e punësimit dhe në fushën e arsimit, gjatë vitit 2021 janë dhenë 62 vendime diskriminimi nga të cilat 50 vendime diskriminimi kundër subjekteve publike⁵. Një raport i tillë, ku pjesa dërrmuese e konstatimit të diskriminimit nëpërmjet vendimeve të KMD, sanksionon subjektet publike vlen të hulumtohet dhe analizohet më tej nga Zyra e KMD, për të arritur në disa rekomandime që mund të përkthehen në politika të përgjithshme apo të veçanta për institucionet lidhur me parandalimin dhe luftën kundër diskriminimit.

8. Referuar parashikimeve të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, KMD ka të drejtë të depozitojë pranë organeve gjyqësore, kërkesë padi për çështje që lidhen me fushën e diskriminimit, përfshirë dhe vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese.

Gjatë vitit 2021, Gjykatat kompetente kanë dalë me një numër të konsiderueshëm vendimesh, përkatësisht 119 vendime, për çështje ku KMD ka qenë palë, në raport me 87 vendime të komunikuar në gjatë vitit 2020. Nga këto 119 vendime, në gjysmën e tyre rezulton se për 58 vendime gjyqësore, KMD ka qenë në cilësinë e palës së paditur. Ndërkohë që në 49 vendime gjyqësore në cilësinë e palës së tretë dhe në 12 vendime në cilësinë e kërkuarit.⁶

⁴ Fq 41 e Raportit Vjetor 2021 të KMD

⁵ Fq 45 dhe 46 e Raportit Vjetor 2021 të KMD

⁶ Fq 62 e Raportit Vjetor 2021 të KMD



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Evidentohet fakti se në mënyrë të ndjeshme vit pas viti është rritur numri i çështjeve gjyqësore, në të cilat Zyra e KMD është pale ndërgjyqëshe. Kjo është shenjë e rritjes së aktivitetit të këtij institucioni por edhe e ndërgjegjësimit të publikut dhe subjekteve të interesuara se vendimmarrjet e KMD-së nuk janë përfundimtare por mund të ankimohen në gjykatë.

KShH vlerëson se në kuadër të detyrave të njohura nga ligji, Zyra e KMD-së duhet të luajë një rol më aktiv, sa i takon vënies në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese. Gjatë vitit 2021, KMD është bërë pjesë e procedurave para Gjykatës Kushtetuese, e cila e ka ftuar për të dhënë mendimin e tij me shkrim në lidhje me kërkesën me objekt: “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e RSH i pikës 1 të nenit 162 të Ligjit Nr. 10 019 datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Në parashtrimet e tij, Komisioneri ka theksuar faktin që në bazë të frymës së Kushtetutës dhe standarteve ndërkombëtare mbi zgjedhjet, brenda mundësive, ligji duhet të garantojë barazinë e votës dhe përmes saj barazinë e shanseve për të gjithë kandidatët dhe forcat politike pjesëmarrëse në zgjedhje.⁷

Mgjith, KShH vëren se nuk rezulton që prej saj të jetë vendosur në lëvizje, në cilësinë e subjektit kërkues, Gjykata Kushtetuese, në përputhje me rastet kur kjo zyrë gëzon legjitimitetin aktiv për të bërë të mundur këtë. Ndaj do të ishte e sugjerueshme, përdorimi më efikas nga Zyra e KMD i të gjitha mjeteve ligjore në dispozicion të saj, sidomos i atyre të cilët sjellin trajtimin e problematikave ligjore në shkallë të gjerë dhe jo vetëm për një individ.

KShH në disa gjykime, përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka thirrur apo konstatuar prezencën e KMD në cilësinë e personit të tretë. Në këto çështje, evidentohet kontributi cilësor i përfaqësuesve të KMD në qëndrimet e mbajtura para gjykatës, në drejtim të analizimit të situatës dhe elaborimit të bazës ligjore konkrete.

8. Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të KMD-së, parashikuar nëpërmjet një serë kompetencash për këtë qëllim, si: nxitja e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara; adresimi drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin; informimi për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje; zhvillimi i dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuëse dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.⁸

Vlerësojmë se do të ishte efektive, shtrirja e aktivitetit ndërgjegjësuës, të zhvilluar nga Zyra e KMD edhe në terren. Në këtë mënyrë do të bëhej e mundur, aksesimi nga grupet e marginalizuara apo ato me rrisht të lartë për tu diskriminuar, të informacionit dhe aktivitetit

⁷ Fq 61 e Raportit Vjetor 2021 të KMD

⁸ Fq 80 e Raportit Vjetor 2021 të KMD



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

ndërgjegjësues të organizuara nga Zyra KMD-së. Gjithashtu për shkak të kontaktit në mënyrë direkte me këto grupe, Zyra e KMD-së do të kishte mundësi të kryente një tjetër funksion të saj, atë të kryerjes së sondazheve mbi efektivitetin e masave kundër diskriminimit apo për parandalimin e tij, të ndjekura prej saj. Zhvillimi i aktiviteteve sensibilizuese me shkollat gjithashtu do të ishte një drejtim i këshillueshëm i cili do të shërbente përmbushjes së detyrave që ligji i njej mbi aktivitetin e tij sensibilizues.

9. Në kuadër të detyrave ligjore Zyra e KMD gjatë vitit 2021 ka realizuar disa publikime të materialeve studimore.⁹ Këto dokumenta informues janë një kontribut i rëndësishëm për analizimin dhe grumbullimin e të dhënave konkrete mbi çështje të ndryshme.

Informimi i grupeve të interesit me përmbajtjen e këtyre materialeve, në forma sa më inovatore dhe në gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme, dhe që kanë një arritje sa më të gjerë të shtetasve dhe veçanërisht të grupeve në nevojë, ka rëndësi kryesore, për arritjen e objektivave kundër diskriminimit. Gjithashtu do të ishte e vlerësueshme nëse Zyra e KMD do të analizonte në vijimësi realizimin e rekomandimeve të cilat janë gjeneruar nga publikimet e saj.

⁹ Fq 92 e Raportit Vjetor 2021 të KMD